



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.\_\_.2021

**VENDIM**

**Nr. 191, datë 07.05.2021**

**PËR**

**TRANSFERIMIN E PËRKOSHËM ME PËLQIM TË GJYQTARIT Z. {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 1, të nenit 147 dhe në shkronjën “a”, pika 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në shkronjën “a”, pika 2, të nenit 61 dhe në shkronjën “c”, të nenit 86, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në pikën 1, të nenit 46, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në nenin 9, të Vendimit të tij nr. 23, datë 07.02.2019, “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkoshëm të gjyqtarit”, i ndryshuar, pasi shqyrtoi kërkesat e gjyqtarëve që kanë dhënë pëlqimin për transferim të përkoshëm, znj. Ema Shaholli, z. {...} dhe znj. Marjola Beluli, mbi propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës dhe pas shortit të hedhur,

**VENDOSI:**

1. Transferimin e përkoshëm me pëlqim të gjyqtarit z. {...}, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, për një periudhë deri në një vit.
2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 01.06.2021.
3. Përrjashtimin e gjyqtarit z. {...} nga procedurat e shortit pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër.
4. Efektet financiare sipas këtij vendimi përballohen nga Gjykata Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër.
5. Një kopje e vendimit i njoftohet z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**